



AUTORITETI KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

MBROJTJA E FËMIJËVE & TË RINJVE *ONLINE*

WEBINAR

27 SHTATOR 2024



PËRMBAJTJA

- ❑ LLOJET E KËRCËNIMEVE *ONLINE* DHE SFIDAT E TEKNOLOGJIVE MODERNE
- ❑ ROLI I AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE (AKSK)
- ❑ ROLI I PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT
- ❑ RAPORTO



LLOJET E KËRCËNIMEVE *ONLINE* DHE SFIDAT E TEKNOLOGJIVE MODERNE

NJOHJA ME NJERËZ TË PANJOHUR *ONLINE*

DHUNA DHE KËRCËNIMI *ONLINE* (*CYBERBULLYING* – BULLIZMI KIBERNETIK)

EKSPOZIMI NDAJ PËRMBAJTJEVE TË PAPËRSHTATSHME

NDARJA E INFORMACIONEVE PERSONALE *ONLINE*

TRAFIKIMI *ONLINE* I QENIEVE NJERËZORE

RADIKALIZMI *ONLINE*

GROOMING

PHISHING

aksk.gov.al/wp-content/uploads/2023/07/Mbroni-privatesine-e-femijeve-tuaj-Video-ndergjegjesuese.mp4



LLOJET E KËRCËNIMEVE ONLINE

Bullizmi kibernetik te fëmijët ndodh kur dikush përdor mjetet e telekomunikacionit (mediat sociale) për komunikimin apo shpërndarjen e përmbajtjeve të ndryshme (mesazhe, foto) me qëllim ngacmimin, poshtërimin, turpërimin apo kërcënimin e fëmijëve ose personave nën 18 vjeç.

Grooming

Është veprimtaria e vendosjes së kontaktit / fillimit të një marrëdhënie me një fëmijë, personalisht apo me anë të përdorimit të internetit ose teknologjive të tjera digjitale, për të mundësuar ndërveprimin seksual me fëmijën. Ndërveprimi seksual mund të ndodhë *online* ose në jetën e përditshme.

Gjuha e urrejtjes mbulon të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë ose forma të tjera urrejtjeje të bazuara në intolerancë. Kjo përfshin intolerancën e shprehur nga nacionalizmi agresiv apo nga diskriminimi dhe armiqësia kundër pakicave, emigrantëve etj.



LLOJET E KËRCËNIMEVE ONLINE

Phishing ndodh kur një person dërgon një tekst të rremë, email ose mesazh pop-up për t'i bërë njerëzit të ndajnë informacionin e tyre personal, fjalëkalimet ose informacionin financiar. Pasi të kenë këtë informacion, këta sulmues përdorin informacionin e mbledhur për të kryer vjedhje identiteti ose për të vjedhur para.

Radikalizmi online është aksesimi ose ekspozimi ndaj materialeve ekstremiste në internet nëpërmjet mediave sociale ose platformave të tjera online - për shembull propaganda duke përfshirë fotografi, video, blogje dhe lajme të rreme, ekspozimi ndaj aktiviteteve ekstremiste, terroriste etj

Trafikimi online i qenieve njerëzore përfshin përdorimin e internetit dhe teknologjive digjitale për të rekrutuar, shfrytëzuar dhe kontrolluar individët në forma të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore.



ROLI I AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË KIBERNETIKE

AKSK ushtron, ndër të tjera, këto kompetenca të parashikuara në **Ligjin nr.25/2024 “Për sigurinë kibernetike”**:

- kryen aktivitete ndërgjegjësimi në fushën e sigurisë kibernetike për të gjitha grupet e shoqërisë;
- ndërmer masa të nevojshme, bashkëpunon dhe bashkërendon punën me institucionet përgjegjëse për sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve për krijimin e një mjedisi *online* të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025: Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit

Objektivat specifik:

- Forcimi i kuadrit ligjor për rritjen e sigurisë së fëmijëve në internet
- Parandalimi i abuzimit seksual të fëmijëve në internet nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe krijimit të hapësirave të sigurt për lundrimin në internet
- Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve në internet



Numri i raportimeve për mbrojtjen e fëmijëve online

Janar - Shtator 2024

Numri i raportimeve për mbrojtjen e fëmijëve online

Janar - Shtator 2024





DISA KËSHILLA TEKNIKE

- **Sigurohuni që faqet e internetit që ju apo fëmijët tuaj përdorin të jenë të sigurta**

Po kështu rekomandojmë që prindërit duhet të zgjedhin lojra të përshtatshme për fëmijët e tyre. Kujtojmë që çdo lojë që zgjedhin ka informacion për moshën e përshtatshme.

- **Çaktivizoni blerjet brenda aplikacioneve.**

Shumë aplikacione dhe lojëra u japin mundësi përdoruesve blerjen e funksioneve shtesë të lojës, pikëve/bonuseve shtesë. Fëmijët mund të bëjnë lehtësisht blerje pa e kuptuar ata vetë. Mund të çaktivizoni blerjet brenda aplikacionit, duke lexuar udhëzimet që pajisja teknologjike ka.

- **Ruani informacionin personal**

- **Mësojini fëmijët të përdorin mjete bllokimi dhe raportimi**

- **Mësojini fëmijët tuaj të raportojnë të gjitha aktivitetet e dyshimta**

Bini dakord me fëmijën tuaj se çfarë duhet të bëjnë kur gjërat shkojnë keq. Një rekomandim mund të jetë mbyllja e laptop, fikja e ekranit dhe të kërkuarit e ndihmës te ju.





DISA KËSHILLA TEKNIKE

- Aktivizo **SAFE SEARCH HELP**, për të minimizuar rrezikun që fëmija juaj të përballet me përmbajtje të papërshtatshme, duke aktivizuar “safe search”, në opsionet e treguara.

Shembuj se si të aktivizohen kontrollet prindërore në iPhone-in, iPad-in dhe iPod touch-in e Fëmijës tuaj (të gjitha kategoritë e fëmijëve përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara) 1.

<https://support.google.com/websearch/ansëer/510?co=GENIE.Platform=Android&hl=2>.

<https://support.apple.com/en-us/HT201304#set-restrictions>

- Përdorni aplikacione të ndërtuara posaçërisht për të asistuar prindërit në këtë sfidë të rëndësishme

- Aplikacioni Google Family Link

Cakton limitet e kohës ne ekran

Përcakton përmbajtjet e përshtatshme për moshën,

Menaxhon llogarinë e fëmijës,

Monitoron vendodhjen

[Google-Family-Link.pdf \(aksk.gov.al\)](#)





CFARË DUHET TË BËJ UNË SI PRIND NË RAST SE IMAZHE INTIME/TURPËRUESE TË FËMIJËS TIM SHPËRNDAHEN ONLINE ?

- ❖ Dëgjoje me vëmendje dhe mos e gjyko.
- ❖ Mblidh sa më shumë fakte. Shpërndarja e imazheve të fëmijëve është e ndaluar me ligj. Mblidh fakte dhe mos fshi asnjë bisedë apo imazh. Raporto ato në polici
- ❖ Në rast se këto foto janë të fëmijëve të tjerë dhe ju jeni në dijeni, këshillojini fëmijët tuaj të mos ndikojnë në shpërndarjen e lajmit dhe të shtypin butonin Block ose Report.
- ❖ Fëmijët duhet të njohin pasojat, dëmet emocionale dhe psikologjike të Cyberbullying, Friends online, Sexting etj. Këtë gjë mund ta bëni duke treguar histori, video apo mënyra të tjera komunikimi.
- ❖ Fëmijët duhet të njohin dhe kuptojnë që interneti është pjesë e rëndësishme e jetës tonë, por thjesht silli në vëmendje që duhet të jenë të përgjegjshëm në përdorimin e tyre.
- ❖ Kontakto psikologun e shkollës dhe mësuesin.
- ❖ Raporto përmbajtje të paligjshme/dëmshme në internet në faqen zyrtare të AKSK ne linkun [Raporto - AKSK](#)





CFARË DUHET T'U MËSOJMË FËMIJËVE DHE TË RINJVE PËR PËRDORIMIN E INTERNETIT?

- ❖ MËSOJUNI FËMIJËVE RËNDËSINË E FJALËKALIMEVE TË FORTA
- ❖ EDUKOJINI PËR ZBATIMIN E NJË RUTINE TË SIGURT NË INTERNET
- ❖ Fëmijët duhet të dinë se një i huaj në internet paraqet një rrezik! Ata duhet të shmangin bisedën me persona të huaj në çdo platformë online
- ❖ BËHUNI PJESË E MARRËRDHËNIES SË FËMIJËS ME BOTËN ONLINE
Mënyra më e zgjuar për të garantuar sigurinë e fëmijës tuaj në internet është duke qenë pjesë e aktiviteteve të tij në internet
- ❖ NDËRGJEGJËSOJINI FËMIJËT PËR KËRCËNIMET E MUNDSHME QË MUND TË HASIN NË INTERNET
Ndërgjegjësimi i fëmijëve për rreziqet e ndryshme në internet mund të jetë këshilla më e mençur e sigurisë në internet për fëmijët në botën e sotme
- ❖ TRAJNOJINI FËMIJËT PËR TË KLIKUAR ME KUJDES!
Edukoni fëmijët që të mos klikojnë në linqe të panjohura. Mësojini të qëndrojnë larg çdo platforme që automatikisht të drejton në faqe të tjera
- ❖ MOS HARRONI SE ASPEKTET POZITIVE TË INTERNETIT I TEJKALOJNË ATO NEGATIVE
Interneti është një burim i shkëlqyer mësimor dhe argëtues për fëmijët. Inkurajoni fëmijën tuaj të eksplorojë internetin në potencialin e tij të plot





KU DUHET TË DREJTOHENI PËR NDIHMË NISUR NGA SHKALLA E RREZIKUT QË PARAQET SITUATA?

- Në faqen zyrtare të AKSK në linkun: <https://aksk.gov.al/raporto-3/>
- Policia 112 dhe 129
- Punonjësi i mbrojtjes së fëmijëve në Bashki
- Mësuesi/ psikologu i shkollës/ punonjësi social / Oficeri i sigurisë në shkollë



MBROJTJA E FËMIJËVE & TË RINJVE *ONLINE*

PYETJE?!

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!